



INFORMACION I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISE BIZNESIT

FONDI BESA. Sh.a

1. Emri dhe detajet e kontaktit të Institucionit Financiar

Institucioni:	Fondi Besa sh.a
Adresa:	Rruga: "Brigada VIII", Pallati nr. 5, Tiranë
Numri i Telefonit:	04 2253841/2
Celular:	+355 682003321
Adresa postës elektronike:	mfi@besa.org.al
Numri i faksit:	04 2253836
Adresa e web-it:	www.fondibesa.com

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të Kredisë së Biznesit

Lloji i Kredisë	<p>Qëllimi i kredisë së biznesit është financimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Kredia përdoret për hapjen e një biznesi të ri si dhe zgjerimin e përmirësimin e atij aktual. Ajo iu mundëson blerjen e linjave të prodhimit, objekteve e aktiveve të tjera fikse, rinovimin e zgjerimin e biznesit, rritjen e kapacitetit të prodhimit, blerjen e mallrave etj. Klienti duhet të ketë burim të sigurtë të ardhurash ku përfshihen paga, të ardhurat nga biznesi i tij dhe të ardhurat nga kontratat e qirasë, kur këto janë të deklaruara.</p>
Kriteret minimale që duhet të përmbushë klienti për të marrë një kredi pranë Fondit Besa	<ul style="list-style-type: none">• Klienti duhet të jetë shtetas shqiptar.• Aktiviteti që do të financohet të jetë i ligjshëm.• Mosha minimale e klientit të jetë 18 vjeç. Mosha maksimale për shlyerjen e kështit të fundit të jetë deri në 65 vjeç për femrat dhe 68 vjeç për meshkujt.• Të mos jetë refuzuar aplikimi për kredi në Fondin Besa 6 muajt e fundit.• Histori të mirë kredie në Fondin Besa.• Produkti i kredisë i ofruar nga Fondi Besa përputhet me nevojat e klientit.• Autorizim për të kontrolluar regjistrin e kredive të Bankës së Shqipërisë.• Gatishmëri për të plotësuar aplikimin për kredi.• Aplikuesi jeton dhe /ose punon në zonën që mbulohet nga dega.• Aplikuesi mund të identifikohet lehtësisht dhe ka paraqitur një dokument identifikimi.

Vlera totale e kredisë	deri në 10,000,000 LEK
Monedha	LEK ose EURO
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve	<p>Disbursimi i kredisë mund të bëhet me çek apo me transfertë bankare në llogarinë e klientit, në varësi të shumës së kredisë.</p> <p>Kredia do të disbursohet vetëm pasi klienti të ketë përmbushur kërkesat e Fondit Besa, para lëvrimin të fondeve.</p> <p>Në rastet kur llogaria e klientit është në një bankë të ndryshme nga ajo ku Fondi Besa ka llogaritë e veta dhe pas rënies dakort për kryerjen e pagesës, shpenzimet shtesë për këtë transfertë janë detyrim i klientit.</p> <p>Në lidhje me disbursimin me çek, duhet pasur parasysh që çeku ka një afat të caktuar, kështu që klienti duhet të kryejë veprimet menjëherë pas marrjes së çekut. Pasi klienti të marrë çekun ai/ajo duhet të firmosë kopjen e çekut dhe të vendosë datën mbi të. Kjo kopje do ti bashkëngjitet kopjes së kontratës së kredisë që Fondi Besa mban në zyrat e saj.</p>
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	Nga 6 deri në 120 muaj
Këstet dhe kur është e mundur mënyra se si do të shlyhen këstet.	<p>Kredia paguhet në këste mujore. Kësti i kredisë përbëhet nga principalit dhe interesi. Metoda e llogaritjes së interesit dhe principalit specifikohen në kontratën e kredisë. Pagesa e këstit të parë të kredisë do të bëhet në muajin e ardhshëm pas disbursimit të kredisë, nëse disbursimi është bërë para datës 15 të muajit ose në muajin tjetër në rastet kur disbursimi është bërë pas datës 15 të muajit.</p> <p>Plani i amortizimit të kredisë merret në degët tona sipas kërkesave të paraqitura nga klienti dhe kushteve të Fondit Besa në momentin e aplikimit.</p> <p>Plani i amortizimit nuk përbën detyrim ligjor as për klientin dhe as për bankën.</p>
Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar	<p>Në totalin e shumës që klienti do ti paguajë institucionit përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shuma e fondeve të disbursuara • Shuma e interesave • Komision Disbursimi (Fondi i garancisë) <p>Gjithashtu klienti do të paguajë edhe kosto shtesë që janë të detyrueshme për përfitimin e kredisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pagesat për bllokimin e kolateralit • Noterizimi i kontratës së kredisë <p>Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme përpara disbursimit të kredisë dhe ekzekutohen vetëm një herë.</p>
Garanci/siguri të nevojshme	Fondi Besa, në varësi të shumës së kërkuar për kredi kërkon garanci të tilla si hipotekë, barrë siguroese apo peng. Gjithashtu, kërkon edhe garantor për të gjitha kreditë e biznesit.

3. Kostoja e kredisë

Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.	<p>Kredia jepet në monedhën vendase - LEK</p> <p>Norma vjetore e interesit varion nga 22.56% deri në 28.8% në varësi të shumave, të kohëzgjatjes dhe të garancisë.</p>
Norma efektive e interesit (NEI)	<p>Norma efektive e interesit (NEI) përcakton koston totale që klienti do të paguajë për kredinë e marrë me kushtin që kredia do të shlyhet për periudhën e rënë dakord, palët i përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë dhe interesi dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara deri në fund të maturimit të kredisë.</p>

	<p>Klienti do të informohet për NEI në momentin e aplikimit dhe gjithashtu në disbursimin e fondeve si dhe do ta ketë të evidentuar me shkrim në kontratën e kredisë.</p> <p>Shembull:</p> <table border="1"> <tr> <td colspan="2">Të dhëna për kredisë</td> </tr> <tr> <td>Shuma e kredisë</td> <td>1,000,000</td> </tr> <tr> <td>Norma vjetore e Interesit</td> <td>24.96%</td> </tr> <tr> <td>Kohëzgjatja e kredisë në vite</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Numri i kësteve në vit</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>Data e fillimit të kredisë</td> <td>01/02/2017</td> </tr> <tr> <td>Interesi Efektiv</td> <td>28.02%</td> </tr> </table>	Të dhëna për kredisë		Shuma e kredisë	1,000,000	Norma vjetore e Interesit	24.96%	Kohëzgjatja e kredisë në vite	3	Numri i kësteve në vit	12	Data e fillimit të kredisë	01/02/2017	Interesi Efektiv	28.02%
Të dhëna për kredisë															
Shuma e kredisë	1,000,000														
Norma vjetore e Interesit	24.96%														
Kohëzgjatja e kredisë në vite	3														
Numri i kësteve në vit	12														
Data e fillimit të kredisë	01/02/2017														
Interesi Efektiv	28.02%														
Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.	<ul style="list-style-type: none"> • Komision disbursimi: 1%-4% në varësi të kohëzgjatjes së kontratës së kredisë. • Kosto e noterizimit të kontratës • Kosto e bllokimit të kolateralit <p>Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme përpara disbursimit të kredisë dhe ekzekutohen vetëm një herë.</p>														
Kushtet, sipas të cilave kostot e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë.	Nuk aplikohet														
Kostot në rastin e pagesave me vonesë	Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (interesin ose kryegjënë), Fondi Besa përveç normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penaltet në masën 0.2%-1% p.a në varësi të shumës së kredisë, mbi normën e interesit i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së pa paguar (principal + interes) për periudhën në të cilën ai është më vonesë në bazë të kushteve të kontratës.														

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

E drejta për t'u tërhequr	Huamarrësi ka të drejtën të tërhiqet nga kontrata e kredisë brenda një periudhe 14 (katërmbëdhjetë) ditore nga momenti i lidhjes së saj, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Fondit Besa.
Shlyerja (Pagesa) e kredisë para afatit të maturimit.	Kredimarrësi ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë, apo edhe shumën e një kësti apo të shumëfishave të tij. Në këtë rast kredimarrësi nuk paguan penaltet për interesat teorike (të llogaritura sipas kalendarit) të humbura nga kredimarrësi.
Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	Nuk aplikohet
Informimi në rast refuzimi të kredisë	Fondi Besa informon menjëherë konsumatorin në rast të refuzimit të kredisë duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të	Në rastet e ndryshimit të kushteve të punës, publikimi në mjediset e bankës pranohet si formë e mjaftueshme informimi. Të tjera njoftime, kërkesa apo komunikime e tjera do të bëhen në adresën që klienti bën të ditur për Fondin Besa. Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës së huasë bëhen me shkrim.

cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.	
Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt Fondit Besa.	<p>Ankesë me shkrim pranë degës ku ka marrë shërbimin. Ankesë me shkrim në zyrën qendrore me adresë: Rr. "Brigada VIII", Pall. Nr.5, Tiranë Telefon në numrin celular të dedikuar për ankesat: +355 682003321 Nëpërmjet postës elektronike në adresën: mfi@besa.org.al Pranë çdo dege dhe në faqen tonë të internetit www.fondibesa.com do të gjeni formularët e ankesave. Klienti ka të drejtë të shprehë ankesat apo sugjerimet e tij edhe verbalisht me oficerin e kredisë apo drejtorin e degës ku ka marrë shërbimin.</p>
Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	<p>Ky informacion është i vlefshëm për një periudhë 7 ditore duke filluar prej datës së marrjes së këtij informacioni.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe kushtet e përcaktuara janë të pandryshueshme.</p>

E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura mund të mos jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat që do të përmbajë kontrata e huamarrjes, pasi ato janë subjekt i ndryshueshëm në varësi të shumës së kredisë, kolateralit të ofruar, kohëzgjatjes së kredisë, etj., elemente këto që do të analizohen dhe vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.